



# ÇFARË MUND TË VENDOSË GJYKATA KUSHTETUESE PËR KUVENDIN?

FAQE 4-5



Teksa kanë mbetur pak më shumë se 100 orë nga skadimi i një mase të përkohshme që vendosi Gjykata Kushtetuese e Kosovës, përmes së cilës ndaloi çdo veprim

për formimin e qeverisë së re të vendit deri më 30 shtator, pyetja se çfarë aktgjykimi për konstituimin e Kuvendit të Kosovës do të nxjerrë autoriteti

më i lartë për interpretimin e Kushtetutës sa shkon e bëhet më e dëgjuar. Kemi biseduar me njohës të drejtësisë të cilët shpalosin skenarët e mundshëm

**KOSOVA THOTË SE DRONË TË DYSHUAR NGA SERBIA KANË FLUTURUAR MBI TERRITORIN E SAJ** F. 3



**RAMA LIRON NGA PAGESA E TRANSPORTIT URBAN DISA KATEGORI, SHOQËRIA CIVILE E VLERËSON "VENDIM ELEKTORAL"** F. 3



## OPINION

**A DO TË ARRIJË KOSOVA TA SHPËTOJË DRININ E BARDHË?** F. 7

Ec ma Ndryshe



## AKTUALE



**TRUMPI ZOTOHET SE S'DO TA LEJOJË IZRAELIN TA ANEKSOJË BREGUN PERËNDIMOR** F. 2

**ISH-USHTARI I UÇK-së DORËZON PADI PËR DIMAL BASHËN** F. 3

## EKONOMI



**REGJISTRIMI I BIZNESEVE, EDHE PËRMES PLATFORMËS ELEKTRONIKE E-KOSOVA** F. 8

**LANSOHET FUSHATA KOMBËTARE "MBROJE, DUAJE, MBAJE"** F. 8

## SPORT

**PRISHTINA, LIDERE E SUPERLIGËS** F. 10

**RENOVA**  
PUTZ  
Magedoni  
Xhepçisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@ml.net.mk](mailto:renova@ml.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegji.biznesi.com](http://www.kolegji.biznesi.com)  
info@kolegji.biznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n. Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

# TRUMPI ZOTOHET SE S'DO TA LEJOJË IZRAELIN TA ANEKSOJË BREGUN PERËNDIMOR

WASHINGTON, 26 SHTATOR - Presidenti i Shteteve të Bashkuara, Donald Trump, u zotua se nuk do ta lejojë Izraelin ta aneksojë Bregun Perëndimor, duke i kundërshtuar thirrjet e disa politikanëve të ekstremit të djathtë në Izrael që duan ta zgjerojnë sovranitetin mbi tokën palestineze dhe t'i shuajnë shpresat për një shtet palestinez. Kryeministri i Izraelit, Benjamin Netanyahu, është përballur me trysni të madhe nga disa aleatë brenda koalicionit qeverisës për ta aneksuar Bregun Perëndimor, gjë që i ka shqetësuar liderët arabë, disa prej të cilëve u takuan të martën me Trumpin në marginat e Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara në Nju-Jork. "Unë nuk do ta lejoj Izraelin ta aneksojë Bregun Perëndimor. Jo, nuk do ta lejoj. Nuk do të ndodhë", u tha Trumpi



gazetarëve në Zyrën Ovale. "Mjaft është mjaft! Ka ardhur koha të ndalet tani", shtoi ai. Franca, Britania, Kanadaja, Australia dhe Portugalia janë ndër vendet që kanë njohur shtetin palestinez ditët e fundit, pjesërisht për ta mbajtur gjallë mundësinë e një zgjidhjeje me dy shtete. Izraeli e ka dënuar vendimin e

tyre për njohjen e shtetit palestinez. Ndërkohë, Netanyahu ka mbërritur në Nju-Jork për të mbajtur një fjalim në Kombet e Bashkuara të premtën. Zyra e Netanyahut tha se kryeministri do t'i përgjigjet deklaratës së Trumpit sapo të kthehet në Izrael. Vendbanimet izraelite janë rritur

në madhësi dhe numër qëkurse Izraeli e pushtoi Bregun Perëndimor gjatë luftës së vitit 1967. Ato shtrihen thellë në tokën palestineze me një sistem rrugësh dhe infrastrukturë tjetër nën kontrollin izraelit, duke e copëtuar më shumë tokën. Një plan për vendbanime izraelite, i njohur si projekti E1 dhe i dënuar nga shumë vende, u miratua në gusht. Ky projekt do ta ndajë në dysh Bregun e pushtuar Perëndimor dhe do ta shkëpusë nga Jerusalemi Lindor. Ministri i Financave i Izraelit, Bezalel Smotrich, një ultranacionalist në koalicionin e djathtë që mban Netanyahun në pushtet, tha në atë kohë se "shteti palestinez po hiqet nga tavolina". Vendet arabe dhe myslimane e paralajmëruan Trumpin gjatë një takimi në fillim të kësaj jave për pasojat e rënda të aneksimit

të Bregut Perëndimor - një mesazh që presidenti amerikan "e kupton shumë mirë", sipas ministrit të Jashtëm saudit, princit Faisal bin Farhan Al-Saud. Rreth 700 000 kolonë izraelitë jetojnë mes 2.7 milionë palestinezëve në Bregun Perëndimor dhe Jerusalemin Lindor, të cilin Izraeli e aneksoi në një veprim që nuk njihet nga shumica e vendeve. Izraeli nuk pranon të heqë dorë nga kontrolli mbi Bregun Perëndimor. Shumica e bashkësisë ndërkombëtare i vlerëson vendbanimet izraelite në Bregun Perëndimor si të paligjshme sipas së drejtës ndërkombëtare. Izraeli e kundërshton këtë, duke cituar lidhjet historike dhe biblike me këtë tokë dhe duke thënë se vendbanimet ofrojnë thellësi strategjike dhe siguri.

## POLONIA RIHAP KUFIRIN ME BJELLORUSINË, KINA SYNON T'I MBROJË RRUGËT TREGTARE

Varshavë, 26 shtator - Polonia ka rihapur kufirin me Bjellorusinë pas pothuajse dy javësh. Varshava e mbylli kufirin për shkak të stërvitjeve të përbashkëta ushtarake "Zapad", që Minsku zhvilloi me Rusinë. Pekini duket se ka luajtur rol thelbësor në vendimin për rihapjen e kufirit. Në minutat e para të 25 shtatorit, automjetet e pasagjerëve rinisën kalimin përmes Terespol-Brest dhe kamionët në Kukuriki-Kazloviçi, ndërsa hekurudha e mallrave u rihap përmes Kuznica Bialostocka-Hrodna, Siemianovka-Svislaç dhe Terespol-Brest. Ky hap pasoi një urdhër të ministrit polak të Brendshëm, Marcin Kierwinski, i cili u bë publik nga kryeministri Donald Tusk. Kufiri kishte qenë i mbyllur që nga 12 shtatori, me qëllim të parandalimit të rreziqeve të sigurisë dhe presionit të migracionit.

Që nga viti 2021, Polonia, Lituania dhe Letonia e kanë akuzuar Bjellorusinë për përdorimin e migracionit si armë, duke joshur njerëz nga Lindja e Mesme, Afrika dhe Azia Jugore me viza turistike dhe duke i shtyrë ata drejt kufijve të Bashkimit Evropian. Varshava e ka cilësuar këtë si një operacion hibrid të regjimit të Aleksandr Lukashenkos në Bjellorusi, i mbështetur nga Moska, për ta destabilizuar BE-në. Kjo strategji shkaktoi një krizë humanitare, me migrantë të bllokuar për javë të tëra në pyjet afër kufirit dhe dhjetëra të vdekur si pasojë e ekspozimit ndaj kushteve të ashpra të motit. Të dhënat tregojnë se përpjekjet për kalime të parregullta ranë në fillim të shtatorit, u rritën gjatë stërvitjeve "Zapad" në 687 raste, dhe ranë në 663 javën e kaluar. Midis 20 dhe 23 shtatorit u regjistruan 282 përpjekje për kalim të paligjshëm të kufirit.



### Rruga tregtare e Kinës për në BE

Përfshirja e Kinës në rihapjen e kufirit është kyç. Më 16 shtator, ministri i Jashtëm polak, Radoslaw Sikorski, u takua në Varshavë me homologun e tij kinez, Wang Yi. Sikorski tha se Polonia shpreson që Pekini të

ndihmojë sërish në frenimin e "provokimeve bjelloruse", duke kujtuar se si një takim në vitin 2024 midis liderit kinez, Xi Jinping, dhe presidentit polak Andrzej Duda përkoi me një rënie të përkohshme të kalimeve të paligjshme të kufirit. Analistët thonë se prioriteti i Kinës nuk është përafrimi politik, por mbrojtja e rrugëve tregtare. Kufiri Poloni - Bjellorusi

është një arterie kryesore e Nismës kineze "Brezi dhe Rruga", që transporton mallra nga Kina drejt BE-së. Ndërrprerjet e rrugëve tregtare kërcënojnë që dërgesat të mos arrijnë me kohë dhe minojnë pretendimin e Pekinit se hekurudha euroasiatike është një alternativë e besueshme ndaj rrugëve detare. "Kina dëshiron ta shmangë fajin dhe që dërgesat e saj të vazhdojnë", tha për "Radion Evropa e Lirë", Temur Umarov, hulumtues në Carnegie Endowment. "Fokusi i saj është stabiliteti ekonomik dhe të tregojë se Brezi dhe Rruga funksionon". Nëse diplomacia e Pekinit prapa skenës ka funksionuar do të testohet së shpejti: vetëm një rënie e qëndrueshme e numrit të migrantëve do të konfirmojë nëse Minsku e ka zbutur presionin mbi kufirin me Poloninë për shkak të ndikimit kinez.

## Sondazhi zbulon përmbysjen e zgjedhjeve në Britani

LONDËR, 26 SHTATOR - Një sondazh i ri MRP (Modeli i Parashikimit për Rajonet) tregon se Partia Reform, e udhëhequr nga Nigel Farage, mund të fitojë deri në 311 vende në zgjedhjet e ardhshme të Mbretërisë së Bashkuar, vetëm 15 më pak nga shumica absolute në Parlament. Sipas sondazhit, Reforma kryeson me 27 % ndaj 21 % të Laburistëve, duke

shkaktuar një cunam papëlqyeshmërie për partinë që aktualisht mban pushtetin. Reforma shihet në rritje të fortë, nga 15 % në zgjedhjet e fundit, në 27 % sipas sondazhit më të fundit. Kjo e pozicionon partinë në prag të shumicës absolute me 311 vende, një skenar që do ta vendoste Nigel Farage shumë pranë marrjes së detyrës së

kryeministrit. Mbështetja për Partinë Laburiste ka rënë ndjeshëm, veçanërisht në zonat ku partia kishte shumica të mëdha në zgjedhjet e mëparshme. Parashikohet që Laburistët të humbasin deri në 268 vende, duke mbetur vetëm me 144, një rënie edhe më e madhe sesa sugjeronin sondazhet më

pesimiste. Ndryshe nga zgjedhjet e 2024-s, ku votat e Reformës ishin shumë të shpërndara për të siguruar vende, tani përqendrimi në zonat kyçe po u jep atyre një avantazh elektoral të rëndësishëm. Rënia më e madhe e Laburistëve është në zonat ku Reforma ishte në vend të dytë vitin e kaluar. Partia Konservatore parashikohet



të humbasë rreth 45 vende, duke rënë nën 100 mandate, një tjetër goditje për një parti që qeverisi për më shumë se një dekadë para vitit 2024.

## Ish-ushtari i UÇK-së dorëzon padi për Dimal Bashën

PRISHTINË, 26 SHTATOR - Ish-ushtari i UÇK-së, Agim Pllashniku, përmes përfaqësuesit të tij ligjor, avokatit Gent Gjini, ka dorëzuar të premtën në prokurori padi dhe kallëzim penal ndaj kryeparlamentarit Dimal Basha.

Padia lidhet me pretendimet e Bashës për financimin e

Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës nga kartelët e drogës dhe për bashkautorësinë e tij për publikimin e këtyre pretendimeve në një revistë shkencore të një universiteti në ShBA.

Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Dimal Basha, dy ditë më parë tha se me kërkesën e tij është larguar kapitulli që ai kishte

shkruar dhe i është hequr emri nga autorësia në një punim të vitit 2012 që fliste kundër Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Për këtë punim, ku Basha ishte bashkautor, raportuan mediet në Kosovë pasi ai u zgjodh kryetar i Kuvendit në gusht, duke nxitur reagime të shumta lidhur me përmbytjen.



# KOSOVA THOTË SE DRONË TË DYSHUAR NGA SERBIA KANË FLUTURUAR MBI TERRITORIN E SAJ

**Drejtori i përgjithshëm i Policisë së Kosovës, Gazmend Hoxha, ka thënë të premtën se misioni paqeruajtës i NATO-s në vend, KFOR, është njoftuar për këto shkelje**

PRISHTINË, 26 SHTATOR - Autoritetet e Kosovës kanë thënë se hapësira ajrore e Kosovës është shkelur nga dronë që dyshojnë se janë futur nga fqinja veriore, Serbia, kohët e fundit.

Drejtori i përgjithshëm i Policisë së Kosovës, Gazmend Hoxha, tha të premtën për medie se misioni paqeruajtës i NATO-s në vend, KFOR, është njoftuar për këto shkelje. “Kohën e fundit kemi pasur fluturime të dronëve që ne po dyshojmë që po vijnë nga territori i Serbisë në pjesën veriore të Kosovës. Policia është në kontakt me KFOR-in. Jemi duke bërë monitorimin dhe me pa se çfarë mund të bëhet”, tha Hoxha pas një ceremonie për shkatërrimin e armëve të jashtëligjshme.

Hapësira e ulët ajrore e Kosovës menaxhohet nga Autoriteti i Aviacionit Civil të Kosovës, por hapësira e lartë - ajo mbi 6 200 metra - është nën kontrollin e Hungarisë, përkatësisht të HungaroControl-it, për shkak se Kosova nuk ka arritur ende kapacitete për ta menaxhuar hapësirën e lartë ajrore.

Në përputhje me Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, por edhe me ligjet e tanishme në Kosovë, komandanti i KFOR-it është përgjegjës për sigurinë e hapësirës ajrore të Kosovës që nga viti 1999.

Hoxha tha se futja e dronëve të huaj në hapësirën ajrore të Kosovës “është e rrezikshme për pjesën e kufirit po, por për



qytetarët tanë jo, ne jemi duke i mbrojtur, po ashtu”.

Ai u bëri jehonë deklaratave të ministrit të Brendshëm në detyrë, Xhelal Sveçla, i cili dy ditë më parë foli për mediumin “Koha” për dyshimet se dronë nga Serbia janë futur në hapësirën ajrore të Kosovës. Radio Evropa e Lirë e ka pyetur KFOR-in lidhur me dyshimet për shkelje të hapësirës ajrore të Kosovës, por nuk ka marrë përgjigje të menjëhershme. Autoritetet e Kosovës e kanë akuzuar vazhdimisht Serbinë se përbën rrezik për sigurinë e saj, posaçërisht pas sulmit të shtatorit 2023, kur një grup serbësh të armatosur sulmuan Policinë e Kosovës duke vrarë një rreshter.

Serbia i mohon akuzat. Këtë javë presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, tha gjatë qëndrimit në Shtetet e Bashkuara, se Beogradi paraqet kërcënim të vazhdueshëm për Prishtinën. E pyetur në një intervistë për “Fox News”, nëse Kosova dhe Serbia ishin buzë një konflikti në qershor, Osmani tha se fqinjës veriore të Kosovës i “pëlqen të shkaktojë probleme herë pas here”. Ajo theksoi se administrata e presidentit Donald Trump ka bërë punë të mirë në parandalimin e përshkallëzimit të situatës në mes të Kosovës dhe Serbisë.

Muajt e fundit presidenti Trump disa herë ka deklaruar se ka parandaluar një

përshkallëzim mes Kosovës dhe Serbisë.

### Çfarë tha Trumpi?

Presidenti i ShBA-së, Donald Trump, shkroi në rrjetin Social Truth më 15 qershor, se gjatë mandatit të tij të parë presidencial, Kosova dhe Serbia po “shkonin drejt një konflikti serioz” dhe se lufta ishte në prag të shpërthimit, por ai e ndaloi.

Më 25 qershor, Trumpi tha se “gjatë javëve të fundit u morëm me Indinë dhe Pakistanin, Kosovën, Serbinë. Mendoj se të premtën do të kemi vizita nga Kongo dhe Ruanda”. Ai e bëri këtë deklaratë në një

konferencë për medie në samitin e NATO-s në Hagë.

Më 27 qershor, duke folur në Zyrën Ovale për përpjekjet e administratës së tij për të zgjidhur konflikte të mundshme, Trumpi tha se: “...në Serbi dhe Kosovë zgjidhëm një katastrofë të mundshme.”

Një ditë më vonë, më 28 qershor, Trumpi tha se “për vetëm disa muaj, kemi arritur paqe midis Indisë dhe Pakistanit, Izraelit dhe Iranit, si dhe midis Republikës Demokratike të Kongos dhe Ruandës - dhe disa të tjerë gjithashtu”. “Serbia, e dini, po përgatitej të shkonte në luftë me një grup. Nuk dua ta përmend, sepse nuk ndodhi - ne arritëm ta ndalnim. Por, kam një mik në Serbi që më tha: 'Do të hyjmë sërish në luftë'. Dhe nuk dua të them që është Kosova, por është Kosova. Do të niste një luftë e madhe, por ne e ndalëm. E ndalëm për shkak të tregtisë. Ata duan të tregtojnë me Shtetet e Bashkuara. U thashë: ne nuk tregtojmë me ata që hyjnë në luftë”.

Më vonë, më 9 korrik, ai përsëriti: “Kam arritur të zgjidh shumë situata si ajo me Indinë dhe Pakistanin, Kosovën dhe Serbinë. Thashë: a do të luftoni? Ne nuk do të bëjmë tregti. Dhe, duket se kjo ka qenë mjaft e suksesshme”.

Trumpi e përmendi rastin e Kosovës dhe Serbisë edhe gjatë një takimi me shefin e NATO-s, Mark Rutte, më 14 korrik në Shtëpinë e Bardhë.

## Nënshkruhet marrëveshje bashkëpunimi në mes të Policisë së Kosovës dhe dy institucioneve të arsimit të lartë AAB dhe AUK

Prishtinë, 26 shtator - Me qëllim të ngritjes së mëtejme arsimore dhe zhvillimit të kapaciteteve dhe burimeve njerëzore, më 26.09.2025, në emër të Policisë së Kosovës, drejtori i përgjithshëm i PK-së, kolonel Gazmend Hoxha, ka

nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me zyrtarë nga dy institucionet e arsimit të lartë në Kosovë, respektivisht me AUK dhe AAB.

Gjatë takimit u diskutuan çështje të bashkëpunimit në mes të institucioneve që

përfaqësoheshin në takim. Policia e Kosovës mbetet e përkushtuar që në vazhdimësi të ndërmarrë hapa për mbështetjen e pjesëtarëve të PK-së në fushën e ngritjes së nivelit profesional dhe avancimit të mëtejme të tyre.





# ÇFARË MUND TË VENDOSË GJYKATA KUSHTETUESE PËR KUVENDIN?

Teksa kanë mbetur pak më shumë se 100 orë nga skadimi i një mase të përkohshme që vendosi Gjykata Kushtetuese e Kosovës, përmes së cilës ndaloi çdo veprim për formimin e qeverisë së re të vendit deri më 30 shtator, pyetja se çfarë aktgjykimi për konstituimin e Kuvendit të Kosovës do të nxjerrë autoriteti më i lartë për interpretimin e Kushtetutës sa shkon e bëhet më e dëgjuar. Kemi biseduar me njohës të drejtësisë të cilët shpalosin skenarët e mundshëm

**PRISHTINË, 26 SHTATOR** - Hedhja ndaras në votim e kandidatëve për nënkryetarë të Kuvendit të Kosovës nga komunitetet pakicë u bë shkas që më 5 shtator Gjykata Kushtetuese e Kosovës të vendoste një masë të përkohshme, duke ua ndaluar deputetëve të ndërmerrnin veprime dhe të zhvillonin ndonjë procedurë për formimin e qeverisë së re të vendit për shkak të dyshimeve për shkelje kushtetuese. Lista Serbe u ankua në Kushtetuese për veprimin e kreut të ri të Kuvendit, Dimal Basha, i cili, më vonë, do ta shpallte organin ligjvënës të konstituuar, pavarësisht

moszgjedhjes së nënkryetarit nga minoriteti serb. Kushtetuesja tha se masën, që do të jetë në fuqi deri sa ajo të nxjerrë një aktgjykim, e vendosi në mënyrë ex officio, dhe në bazë të kërkesës së deputetëve të partisë më të madhe të serbëve në Kosovë, duke e arsyetuar me “evitim të rreziqeve ose dëmeve të pariparueshme”. Si mund ta gjykojë Kushtetuesja çështjen? Zahir Çerkini, profesor i së Drejtës Kushtetuese në Universitetin “Isa Boletini” në Mitrovicë, thotë për “Radion Evropa e Lirë” se Kushtetuesja është mbështetur gjithmonë në praktikën e konstituimit të

Kuvendit. Ai parasheh se Gjykata do “të konstatojë se shkelja e vetme ka qenë ndarja e votimit të nënkryetarëve, pasi praktika e deritanishme kërkon zgjedhjen e tyre në pako”.

Çerkini nuk pret “që Gjykata të merret me çështje politike, siç është diskutimi se kush duhet të jetë nënkryetar nga komuniteti serb. Një gjë e tillë nuk është përgjegjësi e saj. Roli i Gjykatës është vetëm të garantojë respektimin e Kushtetutës dhe të procedurës”. Vendim të ngjashëm pret edhe Ehat Miftaraj, drejtor i Institutit të Kosovës për Drejtësi. Por, Lëvizja Vetëvendosje (LV), fituese e zgjedhjeve të 9 shkurtit, ka pritje të tjera. “Ne presim që Kuvendi të konfirmohet si i konstituuar, ngase Kryetari i Kuvendit i ka respektuar dhe ndjekur të gjitha procedurat e parashikuara me Kushtetutë, jurisprudencën e Gjykatës dhe Rregulloren e Kuvendit”, thuhet në një deklaratë të Zyrës për Media të LV-së dhënë “REL”-it. Për LV-në, përfaqësuesja e pakicave joserbe, Emilija


Rexhepi, e cila u zgjodh nënkryetare e Kuvendit, u votua “në mënyrë të rregullt dhe nuk ka drejtë askush t’ia marrë këtë të drejtë grupit multietnik”.

## Votimi për nënkryetarët

Për dallim prej kandidatës së komuniteteve të tjera minoritare, asnjëri nga 10 përfaqësuesit e komunitetit serb nuk arriti të zgjidhet nënkryetar i Kuvendit. Kandidati i vetëm që propozoi Lista Serbe, e cila në Kuvend ka 9 nga 10 vendet e rezervuara për serbët, nuk i siguroi 61 votat e nevojshme as pas tri rundeve të votimit. Pasi partia që gëzon mbështetjen e Beogradit nuk pranoi të propozonte për nënkryetar dikë tjetër përveç Sllavko Simiqit, kryetari Basha hodhi short, sipas Rregullores së punës së Kuvendit, për të nxjerrë një emër tjetër. As të tjerë nga Lista Serbe, e as Nenad Rashedi nga partia serbe Për Liri, Drejtësi dhe Mbijetesë, aktualisht ministër në detyrë në

qeverinë e Albin Kurtit, nuk i morën votat e nevojshme, me ç’rast Basha në mënyrë të njëanshme e mbylli si të përfunduar seancën konstituive. Miftaraj thotë për “REL”-in se “nëse merren për bazë aktgjykimet e Gjykatës Kushtetuese të vitit 2014 dhe 2025 dhe standardi që është ndërtuar në 11 vjetët e fundit lidhur me konstituimin e Kuvendit të Kosovës, Gjykata Kushtetuese mund të vendosë kthimin e votimit në pako për dy nënkryetarët e komuniteteve joshumicë”. Sipas tij, nëse nga Gjykata “merret për bazë Rregullorja e Punës e Kuvendit, e miratuar nga legjislatura e kaluar, mund të sqarohet procedura e votimit të kandidatëve që kanë shumicën e votave të deputetëve nga pakicat”. E, pastaj? Çerkini beson se Gjykata do “të theksojë se procedura e konstituimit duhet të vazhdojë aty ku ka mbetur, duke u shfrytëzuar ditët e mbetura nga afati 30-ditor” i një aktgjykimi paraprak.

# PAQARTËSI RRETH RREGULLORES PËR PARKINGJE NË PRISHTINË, A PO DETYROHEN QYTETARËT TË PAGUAJNË GJOBA KUNDËRLIGJSHËM?



**PRISHTINË, 26 SHTATOR** - Komuna e Prishtinës ka njoftuar se ka rikthyer në fuqi Rregulloren për Parkingjet në Kryeqytet, zbatimi i së cilës ka nisur nga 10 shtatori. Megjithatë, mungesa e hollësive nga komuna dhe ndërmarrja “Prishtina Parking” lidhur me përmbajtjen e kësaj rregulloreje ka shkaktuar paqartësi te qytetarët. Nuk dihet ende nëse rregullorja ka mbetur e njëjtë apo janë bërë ndryshime në mënyrën e zbatimit apo përmbajtjen e saj. Komuna ka bërë me dije se çdo parkim i paautorizuar dhe pa pagesë do të sanksionohet me gjoba dhe masa ndëshkuese, por nuk janë dhënë hollësi shtesë rreth kësaj.

Liridon Salihi, projekt koordinator në Grupin për Studime Juridike dhe Politike, në një intervistë për “Telegrafi”-n, ka thënë se veprimet e fundit të komunës së Prishtinës rreth menaxhimit të parkingjeve publike nuk kanë bazë ligjore. “Qendra për Raste Gjyqësore Strategjike (CSL) si palë që e ka kontestuar Rregulloren e Prishtina Parking

rithekson se veprimet e fundit të Komunës së Prishtinës rreth menaxhimit me parkingjet publike në Kryeqytet nuk kanë asnjë bazë ligjore, e rrjedhimisht janë në kundërshtim edhe me Aktgjykimin e Gjykatës Supreme dhe me vetë Rregulloren. Pra, as rritja e çmimit të gjobës për mos pagesë të tarifës së parkingut dhe as dhënia e kompetencës për Drejtorinë e Inspeksionit nuk mund të bëhet pa plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores, i paraprirë nga konsultimi publik dhe respektimi i procedurave ligjore për miratim, shqyrtim të ligjshmërisë dhe hyrjes në fuqi”, është shprehur ai.

Ndër të tjera, Salihi ka pohuar se qytetarët po obligohen që kundërligjshëm të paguajnë gjoba. “Përmes njoftimit, Komuna e Prishtinës thekson se do të fillojë implementimi i plotë i Rregullores, por në realitet veprimet e fundit të saj bien në kundërshtim me dispozitat në fuqi të kësaj Rregulloreje e rrjedhimisht po i

obligojnë qytetarët që kundërligjshëm të paguajnë gjoba mandatore të lëshuara nga Drejtoria e Inspeksionit”, theksoi Salihi.

Ai ka rikthësuar se gjobat për mospagesë të parkingut sipas njoftimit të fundit të komunës janë të kundërligjshme, duke shtuar se “gjobat, procedura dhe kompetenca për shqiptimin e tyre në rastet kur qytetarët nuk kryejnë pagesën e obligueshme për shfrytëzim të parkingut duhet përcaktohen me Rregulloren, gjithmonë duke i respektuar gjetjet e Gjykatës Supreme”. Ai ka folur edhe për ndikimin që do të ketë te qytetarët kjo rregullore. “Kjo masë ndikon direkt në cenimin e të drejtave të qytetarëve dhe në sigurinë juridike të tyre, duke i obliguar të njëjtë që të paguajnë gjoba të cilat nuk kanë asnjë bazë ligjore”, pohoi ai.

Salihi tha se do të ndërmarrin të gjitha hapat ligjorë për t'i kundërshtuar veprimet që janë të kundërligjshme. “CSL në vazhdimësi është duke i kushtuar vëmendje zhvillimeve

lidhur me parkingjet publike në Kryeqytet. Fillimisht, më 11 shtator 2025, kemi dërguar kërkesë për qasje në dokumentin zyrtar mbi të cilën është vendosur çështja e gjobave dhe kompetenca e Drejtorisë së Inspeksionit. Duke qenë se nga Komuna nuk kemi pranuar përgjigje, më 23 shtator 2025, kemi dorëzuar ankesë kundër Komunës së Prishtinës në Agjencinë për Informim me Privatësi (AIP). CSL i siguron qytetarët që do të ndërmarrë të gjithë hapat ligjor për të kundërshtuar veprimet e kundërligjshme përmes së cilave cenohen parimet kushtetuese dhe interesi publik”, nënvizoi ai.

Për funksionalizimin e rregullores, “Telegrafi” ka dërguar disa pyetje në Prishtina Parking, të cilët thonë se, përveç dispozitës 9 e cila është shfuqizuar nga Gjykata Supreme, pjesa tjetër mbetet në fuqi. “Aktgjykimi i Gjykatës Supreme ka gjetur pjesërisht shkelje në disa nene të Rregullores apo më saktësisht ka shfuqizuar 9 dispozita të

Rregullores për Rregullimin e Parkingjeve në Prishtinë, duke përcaktuar qartë kompetencat dhe mënyrën e zbatimit. Ndërmarrja vazhdimisht ka punuar për rivendosjen e funksionalitetit të Ndërmarrjes, duke u angazhuar të përmbushen të gjitha kërkesat e Gjykatës Supreme. Për të siguruar funksionalitet të plotë dhe përputhje me këtë vendim, është hartuar një marrëveshje ndërmjet Komunës së Prishtinës dhe Ndërmarrjes Publike “Prishtina Parking”. Qëllimi i marrëveshjes është funksionalizimi i Ndërmarrjes duke respektuar Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, si dhe Rregulloren aktuale e cila përveç 9 dispozitave të shfuqizuara, pjesa tjetër mbetet në fuqi”, thuhet në përgjigjen e tyre.

Ndër të tjera, në përgjigjen e tyre thuhet se të gjitha informacionet për shfrytëzimin e parkingjeve gjenden në tabelat informuese të vendosura në çdo vendparkim ku “Prishtina Parking” menaxhon.

OPINION NGA EC MA NDRYSHE

# A DO TË ARRIJË KOSOVA TA SHPËTOJË DRININ E BARDHË?

Pellgu i Drinit të Bardhë është ndër pasuritë më të rëndësishme ujore të Kosovës. Ai furnizon me ujë të pijshëm pjesën më të madhe të vendit, siguron ujitje për bujqësinë, është burim energjie dhe ofron habitat për larmi të gjallë të florës dhe faunës. Përveç vlerës së tij natyrore, Drini i Bardhë ka rëndësi kulturore dhe historike, duke qenë i lidhur ngushtë me jetën e përditshme të komuniteteve përgjatë rrjedhës së tij.

Por pasuria e madhe ujore aktualisht përballet me një sërë sfidash serioze, të cilat, nëse nuk adresohen me kohë, rrezikojnë që në dekadat e ardhshme të përbëjnë krizë kombëtare të ujit. Sfidat në menaxhimin e ujërave janë të konsiderueshme. Ndotja nga ujërat e zeza dhe mbetjet industriale është ndër problemet më të theksuara. Mungesa e impianteve të trajtimit të ujërave të zeza ka bërë që shumica e vendbanimeve përgjatë Drinit të Bardhë t'i shkarkojnë drejtpërdrejt mbetjet në lum. Industrisë i mungojnë filtrat dhe mekanizmat kontrollues, duke e rënduar edhe më shumë situatën.

Shfrytëzimi i pakontrolluar i burimeve ujore po ashtu është sfidë. Ujësjellësit, bujqësia dhe industria e shfrytëzojnë lumin në nivele të larta, shpesh pa licencim dhe pa monitorim. Ky presion, rrezikon balancën ekologjike dhe rrit konfliktet mes komuniteteve për qasje të

barabartë në ujë.

Degradimi i mjedisit, si prerjet ilegale të pyjeve, shfrytëzimi i zhavorrit nga shtrati i lumit dhe ndërtimet pa leje në zonat mbrojtëse janë duke e ndryshuar strukturën natyrore të pellgut. Ky proces jo vetëm që dëmton peizazhin, por përkeqëson edhe cilësinë e ujit dhe rrit rrezikun e përmbytjeve.

Krahas kësaj, pothuajse çdo vit, dhjetëra familje përgjatë Drinit të Bardhë përballet me dëme nga përmbytjet. Mungesa e infrastrukturës së mbrojtjes, digave dhe sistemeve të paralajmërimit të hershëm e lë popullsinë të pambrojtur.

Gjithashtu rritja e temperaturave dhe ndryshimet në ciklin e reshjeve pritet të ndikojnë direkt në rrjedhën e ujit, duke e bërë më të paparashikueshme furnizimin e qëndrueshëm. Ky fenomen i shton edhe më shumë presion sistemit tashmë të brishtë të menaxhimit të burimeve ujore. Banorët që jetojnë përgjatë Drinit të Bardhë janë të parët që e ndiejnë këtë krizë. Bujqësia përballet me mungesë uji për vaditje, duke ulur prodhimin dhe të ardhurat. Familjet rrezikohen nga ndotja e ujit të pijshëm, e cila bart pasoja për shëndetin publik. Komunitetet përballet me dëme materiale nga përmbytjet, ndërsa mjedisi i shkatërruar ndikon në turizëm dhe trashëgimi kulturore.

Prandaj, Plani i Menaxhimit të Pellgut Lumor Drini i Bardhë përmend masat e menaxhimit që



duhet të zbatohen në mënyrë që të arrihet një status i mirë ekologjik i të gjitha ujërave. Ndërtimi i impianteve moderne të trajtimit të ujërave të zeza është prioritet urgjent, për të

ndalur ndotjen e Drinit të Bardhë. Po ashtu, institucionet duhet të forcojnë monitorimin e licencave për shfrytëzimin e ujit, duke vendosur tarifa të drejta dhe duke marrë veprime për të

parandaluar abuzimet.

Mbrojtja e habitateve natyrore është po aq e rëndësishme. Pyllëzimi i zonave të degraduara, ndalimi i prerjeve ilegale dhe kufizimi i nxjerrjes së zhavorrit janë masa të domosdoshme për rikthimin e balancës ekologjike. Nevojiten edhe sistemet e hershme paralajmëruese për përmbytjet. Vendosja e teknologjive moderne për matjen e prurjeve të ujit dhe paralajmërimin e komuniteteve në kohë reale do të shpëtonte jetë dhe pasuri. Gjithashtu fushatat e ndërgjegjësimit për qytetarët dhe përfshirja e shkollave në edukimin mbi ruajtjen e ujit janë thelbësore për ndryshimin e sjelljes në aspektin afatgjatë.

Meqë Drini i Bardhë nuk ndalet në kufijtë e Kosovës, menaxhimi i tij kërkon bashkëpunim me Shqipërinë dhe Malin e Zi për një qasje të integruar dhe afatgjatë. Drini i Bardhë është pasuri kombëtare dhe rajonale, që ndodhet nën presion të madh. Ndotja, shfrytëzimi i pakontrolluar, degradimi i mjedisit dhe rreziqet nga ndryshimet klimatike po e vënë në pikëpyetje të ardhmen e tij. Zbatimi i masave të propozuara në Planin e Menaxhimit nuk janë thjesht rekomandime, por domosdoshmëri për të garantuar që gjeneratat e ardhshme të kenë qasje në ujë të pastër, natyrë të shëndetshme, zhvillim të qëndrueshëm ekonomik dhe integrim evropian.

## TRYEZA PËR PROGRAMIN KOMBËTAR TË SHKENCËS: TË ZVOGËLOHET HENDEKU NË MES TË STRATEGJIVE NË LETËR DHE JETËSIMIT TË TYRE NË PRAKTIKË

**PRISHTINË, 26 SHTATOR** - Drejtues të institucioneve publike të arsimit të lartë, Këshillit Kombëtar të Shkencës, Agjencisë për Akreditimin e Kosovës, Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit u mblodhën në Rektoratin e Universitetit të Prishtinës për të diskutuar rreth zbatimit të Programit Kombëtar të Shkencës.

Duke hapur punimet e tryezës, rektori i Universitetit të Prishtinës, prof. Arben Hajrullahu, tha se për inovacionin, kërkimin shkencor, por edhe çfarëdo çështje që provojnë ta avancojmë, në fillim duhet të dimë ku jemi dhe pastaj edhe nga po shkojmë.

Rektori Hajrullahu konstatoi se është thelbësore për institucionet shtetërore dhe ato publike të arsimit të lartë që të zvogëlohet hendeku mes strategjive të

shkruara në letër dhe jetësimi i tyre në praktikë, duke sugjeruar që strategjitë të mos jenë qëllim në vete.

Kryetarja e Këshillit Kombëtar të Shkencës, prof. Muzaferre Krasniqi-Limani, tregoi objektivat e Programit Kombëtar të Shkencës (2023-2028), me të cilët planifikohet avancim i kërkimit shkencor, lidhje të shkencës, ekonomisë e industrisë, ndërtim të kapaciteteve njerëzore për kërkime shkencore, ndërkombëtarizim dhe përsosmëri e këtyre kërkimeve.

Për ndërlidhjen e studimeve dhe universiteteve me industrinë dhe komunitetin, foli dekani i Universitetit “Haxhi Zeka” të Pejës, prof. Armand Krasniqi. Ai konstatoi se aktualisht as ndërmarrësit e as komuniteti nuk janë të përgatitur për një



ndërlidhje të tillë.

Në tryezë foli edhe drejtori i përgjithshëm i Agjencisë së Kosovës për Akreditim, Naim Gashi, që tha se institucionet publike të arsimit të lartë duhet të ofrojnë programe studimore të përbashkëta.

Gashi propozoi krijimin e zyrave

për përgatitjen e projekteve nëpër universitete për t'i shfrytëzuar fondet, programet e projektet evropiane të arsimit të lartë.

Edhe dekani i Universitetit “Ukshin Hoti” të Prizrenit, prof. Mentor Alishani, tha se asnjë universitet nuk mund të

funksionojë si ishull, duke i cilësuar aleancat mes universiteteve një domosdoshmëri.

Nga tryeza doli konstatimi i përbashkët i rektorëve të universiteteve publike se për të qenë të gjithë të barabartë në garë, institucionet private të arsimit të lartë duhet të funksionojnë si organizata jofitimprurëse.

Tryeza u moderua nga rektorja e Kolegjit Publik Ndërkombëtar të Biznesit në Mitrovicë, prof. Mihone Kerolli, që ishte edhe ideatore e saj, ndërsa u organizua nga Konferenca e Rektorëve të Institucioneve Publike të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës në bashkëpunim me Këshillin Kombëtar të Shkencës dhe Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit.

## Ushtria e Kosovës dhe Shqipërisë rrisin bashkëpunimin në fushën e logjistikës

PRISHTINË, 26 SHTATOR - Në kuadër të bashkëpunimit ushtarak ndërmjet Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) dhe Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë (FARSH), një delegacion nga Komanda Mbështetëse e FARSh-it, udhëhequr nga komandanti, gjeneralbrigade Aleksandër Pando, ka qëndruar në vizitë në Komandën e Logjistikës të FSK-së.

Delegacioni u prit nga zëvendëskomandanti i Komandës së Logjistikës, kolonel Mehmet Lladrovci, që i njoftoi homologët nga FARSh-i me të arriturat, sfidat, ngritjen e kapaciteteve, misionin dhe detyrat e Komandës së Logjistikës, strukturën organizative, aktivitetet dhe zhvillimet e tjera në fushën e logjistikës dhe mjekësore. Gjithashtu, është realizuar vizitë

në servisin për automjetet e rënda, ku patën mundësinë t'i shohin nga afër kapacitetet e mirëmbajtjes.

Gjatë kësaj vizite u rikonfirmua përkushtimi i ndërsjellë për thellimin e bashkëpunimit dhe avancimin e mëtejshëm të kapaciteteve logjistike dhe mjekësore përmes planeve bilaterale dhe shkëmbimit të përvojave dhe praktikave më të mira ndërmjet dy forcave.



## RAMA LIRON NGA PAGESA E TRANSPORTIT URBAN DISA KATEGORI, SHOQËRIA CIVILE E VLERËSON SI “VENDIM ELEKTORAL”

PRISHTINË, 26 SHTATOR - Kryetari i komunës së Prishtinës, Përparim Rama, ka vendosur që nga 1 tetori transporti urban të jetë falas për disa kategori. Por, fakti që ky vendim u mor në kohën e fushatës për zgjedhjet lokale, nga shoqëria civile është cilësuar si “vendim i pastër elektoral”. Sipas vendimit, falas me Trafikun Urban do të mund të udhëtojnë stafi shëndetësor, administrativ dhe mbështetës të institucioneve të kryeqytetit të Kosovës.

Të liruar nga pagesa janë stafi mësimor, përfshirë institucionet parashkollore, të gjithë punonjësit e administratës së Prishtinës, nxënësit e shkollave të mesme dhe studentët e kryeqytetit. “Qytetarët janë prioriteti ynë, për një Prishtinë më të gjelbër dhe me më pak vetura”, shkroi Rama në “Facebook”.

Vendimi, i nënshkruar më 25 shtator, vjen në kohën kur Rama po garon edhe për një mandat katërvjeçar për udhëheqjen e kryeqytetit të Kosovës.

Rama është kandidat i Lidhjes Demokratike të Kosovës për zgjedhjet lokale të 12 tetorit.

Eugen Cakolli nga Instituti Demokratik i Kosovës shkroi në “Facebook” se pavarësisht se



duket vendim i drejtë, fakti që merret në mes të fushatës dhe hyn në fuqi vetëm 12 ditë para zgjedhjeve lokale, “e bën atë një vendim të pastër elektoral”. “Për më keq, ky është shembull tipik i shfrytëzimit të resurseve publike për përfitim elektoral - praktikë për të cilën pikërisht partia që sot udhëheq kryeqytetin akuzonte partinë në pushtet qendror gjatë

zgjedhjeve të 9 shkurtit. Abuzimi me resurset publike për vota është cenim i garës së barabartë zgjedhore, kurdo, kudo dhe nga kushdo që ndodh”, shkroi Cakolli.

Në vendimin e publikuar nga Rama në “Facebook”, thuhet se ai u mor në bazë të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale dhe Statutit të Prishtinës.

Në nenin 53 të Statutit të

Prishtinës, të miratuar më 2010, thuhet se kreu i komunës “merr vendime dhe lëshon urdhëresa brenda fushës dhe kompetencave të tij”.

Kryetarët e komunave, sipas Ligjit për Vetëqeverisje Lokale në Kosovë, kanë kompetenca vetjake, të deleguara dhe të zgjeruara. Sipas këtij ligji, kompetencat vetjake nënkuptojnë kompetenca “që u

jepen komunave me Kushtetutë apo me ligj për të cilat ato janë plotësisht përgjegjëse për sa i përket interesit lokal, apo në përputhje me ligjin”. “Komunat kanë kompetenca të plota dhe ekskluzive për sa i përket interesit lokal, duke i respektuar standardet e përcaktuar në legjislacionin e zbatueshëm”, thuhet në këtë ligj.

Në kompetencat vetjake parashihet ofrimi dhe mirëmbajtja e një sërë shërbimesh publike dhe komunale, përfshirë edhe transporti lokal.

Ndërkaq, në Ligjin për Zgjedhjet Lokale, ndonëse nuk përmendet ndonjë ndalesë për marrjen e vendimeve gjatë fushatës zgjedhore, Neni 3, pika 3.4, thotë se personat që mbajnë post publik, që janë të zgjedhur apo të emëruar, nuk mund ta “përdorin atë post apo ndonjë nga burimet e tij për qëllim të sigurimit të votave”. “Asnjë burim i ndonjë institucioni të administratës publike në nivel qendror ose komunal apo ndonjë ndërmarrje në pronësi apo e kontrolluar nga autoritetet qendrore ose lokale nuk mund të përdoret apo aplikohet në mbështetje të subjektit politik në zgjedhje”, thuhet në ligj.

## Prokuroria e Kosovës ngre aktakuzë ndaj dy përkrahësve të dyshuar të IS-it

PRISHTINË, 26 SHTATOR - Prokuroria Speciale e Kosovës ka ngritur të premten dy aktakuza të ndara ndaj dy personave të dyshuar për nxitje të përçarjes dhe mosdurimit. Në një njoftim për medie, Prokuroria i identifikoi dy të akuzuarit vetëm me inicialet D. B dhe E. B. Ata akuzohen se kanë nxitur dhe përhapur publikisht urrejtje dhe mosdurim ndërmjet grupeve fetare, duke propaganduar ideologji ekstreme fetare dhe duke përkrahur publikisht veprimet e Shtetit Islamik, IS. “D. B dhe E. B., përmes rrjetit social ‘Facebook’ dhe ‘Tik-Tok’, kanë shpërndarë postime me

përmbajtje nxitëse, me thirrje për t’iu bashkuar luftërave të armatosura dhe luftës për xhihad”, thuhet në aktakuzë.

Ata dyshohet se kishin vendosur flamuj të IS-it mbi kulmin e shtëpisë së tyre dhe se kishin bërë grafite me shkronja arabe në muret e shtëpisë.

Prokuroria pretendon se këto veprime mund ta kenë prishur rendin publik. “D. B., sipas provave ka qenë refuzues ndaj të gjithëve që nuk e praktikojnë fenë sipas mënyrës së tij, dhe ka postuar e shpërndarë materiale me gjuhë fyese ndaj shumicës së hoxhallarëve të Bashkësisë Islame të Kosovës”, sipas

aktakuzës.

Prokuroria kërkoi që të dyshuarit me inicialet D. B. t’i vazhdohej masa e paraburgimit, ndërsa atij me inicialet E. B. arresti shtëpiak.

Vepra penale e nxitjes së përçarjes dhe mosdurimit është e dënueshme me gjobë dhe burgim me kohëzgjatje deri në pesë vjet, sipas Kodit Penal.

Kohët e fundit Prokuroria i ka shpeshuar aktakuzat për veprën penale të nxitjes së përçarjes dhe mosdurimit. Muajin e kaluar një person u dënua me 6 muaj burgim për nxitje të përçarjes dhe mosdurimit.



## Lansohet fushata kombëtare “Mbroje, Duaje, Mbaje”

PRISHTINË, 26 SHTATOR - Fondi për Zhvillimin e Komunitetit (CDF) ka lansuar fushatën kombëtare “Mbroje, Duaje, Mbaje”, me qëllim ngritjen e ndërgjegjësimit qytetar dhe fuqizimin e veprimeve të përbashkëta për mbrojtjen e mjedisit. Në lansim u mblodhën mbi 130 pjesëmarrës, përfaqësues të organizatave mjedisore, institucioneve dhe bizneseve.

Në fjalën e tij, ambasadori i Suedisë në Kosovë, Jonas Westerlund, ka theksuar rëndësinë e një partneriteti të gjerë dhe afatgjatë në të gjitha nivelet e shoqërisë, për të ndërtuar një ambient më të pastër dhe më të shëndetshëm, njoftoi CDF përmes një njoftimi në “Facebook”. “Mbroje, Duaje, Mbaje” është një thirrje e hapur për

qytetarët, institucionet dhe bizneset që kujdesi për mjedisin të bëhet pjesë e përditshmërisë sonë. Fushata, e zhvilluar në kuadër të projektit “Fuqizimi i Organizatave të Shoqërisë Civile për Mjedisin në Kosovë (EECSOK)”, implementohet nga Community Development Fund - CDF (CDF) dhe mbështetet nga Embassy of Sweden in Pristina.



## MBAHET PUNËTORIA MBI PAGESAT E SHPEJTA DHE PROJEKTIN E TIPS CLONE

PRISHTINË, 26 SHTATOR - Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK) në bashkëpunim me Shoqatën e Bankave të Kosovës organizoi një punëtori dedikuar pagesave të shpejta dhe platformës TIPS Clone, me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të sektorit bankar dhe ekspertizës ndërkombëtare. Në hapje, zëvendësguvernatori i BQK-së, Dardan Fusha, theksoi rëndësinë strategjike të pagesave të shpejta për sektorin financiar të Kosovës. Ai nënvizoi se projekti, i cili është në zhvillim në bashkëpunim me Bankën e Italisë, është një ndër reformat më



transformuese të infrastrukturës financiare të ndërmarra në vend. Fusha, gjithashtu, potencoi se

pagesat e shpejta do ta nxisin përfshirjen financiare, uljen e kostove të transaksioneve dhe

krijimin e shërbimeve të reja digjitale, si pagesat përmes QR në shitje me pakicë dhe mundësi të reja për e-commerce, duke mundësuar inovacion, konkurrencë të drejtë dhe shërbime më të mira për përdoruesit. Në emër të bashkorganizatorit nga Shoqata e Bankave të Kosovës, kryeshefi ekzekutiv, Petrit Balija, theksoi rëndësinë e bashkëpunimit ndërinstitucional për implementimin me sukses të reformave të tilla transformuese. Eksperti ndërkombëtar Kjeld Herreman, i angazhuar me mbështetjen e Bankës Botërore,

për të pranishmit nga sektori financiar paraqiti aspektet teknike dhe operacionale të platformës së TIPS Clone, duke ndarë praktikat më të mira evropiane dhe ndërkombëtare. Diskutimet përfshinë, mundësitë që sjellin pagesat e shpejta për bankat dhe konsumatorët, kornizën ligjore dhe praktikat në Bashkimin Evropian, dokumentacionin e skemës dhe hapat e implementimit, menaxhimin e likuiditetit, sigurinë dhe parandalimin e mashtrimeve, si dhe ndikimin e operimit 24/7 në IT dhe proceset operative.

## REGJISTRIMI I BIZNESEVE, EDHE PËRMES PLATFORMËS ELEKTRONIKE E-KOSOVA

**Qendresa RAMA**  
PRISHTINË, 26 SHTATOR - Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (MINT) ka njoftuar se tashmë ka filluar regjistrimi i bizneseve edhe përmes platformës elektronike e-Kosova, të bazuar në vendimin nr.2 99 të datës 05.06.2025, të nxjerrë nga Drejtorja Ekzekutive në Agjencinë e Regjistrimit të Bizneseve (ARBK) se nga data 9 qershor 2025, regjistrimi fillestar i shoqërive tregtare në Republikën e Kosovës do të mundësohet edhe përmes platformës elektronike e-Kosova. Sipas MINT-it, regjistrimi i

shoqërive tregtare përmes platformës e-Kosova do të jetë plotësisht online. Aplikimi, miratimi i lëndës dhe lëshimi i certifikatës elektronike do të bëhet përmes kësaj platforme, pa pasur nevojë që aplikuesi të paraqitet në sportele të ARBK-së dhe t'i dorëzojë dokumentet në formë fizike. “Regjistrimi përmes sistemit ekzistues e-Regjistri i Biznesit do të vazhdojë të funksionojë në mënyrë pjesërisht elektronike, ku aplikimi dhe miratimi bëhen online, ndërsa certifikata mund të merret në sportelet e ARBK-së, apo në Qendrën Komunale të Biznesit (QKB) në komunë, ku biznesi ushtron veprimtarinë ekonomike”,



thuhet në njoftim. Sipas njoftimit, dokumentet e bashkangjitura nga aplikuesi në formë elektronike do të arkivohen

në formë fizike nga zyrtarët e ARBK-së apo QKB-të. Aplikuesi nuk obligohet t'i dorëzojë dokumentet në formë fizike në

ARBK apo QKB-të. “Përmes platformës e-Kosova bizneset do të kenë mundësi t'i sigurojnë informatat dhe historinë e biznesit në mënyrë të plotë elektronike, pa pasur nevojë të paraqiten në sportelet e ARBK-së. Aplikimi për regjistrimin fillestar të shoqërive tregtare qoftë përmes e-Kosova, sistemit e-Regjistri i Biznesit, apo në mënyrë fizike në sportelin e ARBK-së, apo QKB-së, vazhdon të jetë pa pagesë”, thuhet në komunikatë. Për më tepër thuhet se sportelet e ARBK-së dhe QKB-ve do të vazhdojnë të jenë të hapura dhe të operojnë për bizneset dhe qytetarët për shërbimet që kërkohen në formë fizike.

## ASK-ja merr pjesë në Forumin Evropian për Gjeografi dhe Statistika

Prishtinë, 26 shtator - Në Forumin Evropian për Gjeografi dhe Statistika (EFGS), Agjencia e Statistikave e Kosovës u përfaqësua nga Burim Limolli dhe Idriz Shala, të cilët paraqitën temën “Modernizimi i shpërndarjes së të dhënave të regjistrimit të popullsisë: zbatimi i WebGIS-it në ASK”. Në prezantim u theksuan

përdorimi i metodës CAPI në gjeo-lokacionin e çdo banese dhe ekonomie familjare, integrimi i të dhënave të validuara në ASKdata (PX-Web), zhvillimi i një platforme të brendshme - WebGIS - që do të jetë në dispozicion së shpejti edhe për përdoruesit e jashtëm, dhe panele që ofrojnë pamje të shpejtë mbi popullsinë dhe strukturën

demografike. Projekti i WebGIS-it, përdorimi i metodës CAPI, zhvillimi i platformës ASKData dhe modulet e tjera, janë një hap i rëndësishëm drejt përmirësimit të qasjes në të dhënat e Regjistrimit të Popullsisë dhe mbështetjes së vendimmarrjes më t'u informuar, në përputhje me praktikat evropiane dhe ndërkombëtare.



# SHQIPTARËT DHE KORRUPSIONI NË KOHËN E ZOGUT

Nga: Vandeleur ROBINSON[1]  
Përktheu: Agron SHALA


Një nga vështirësitë e Mbretit Zog ishte të gjente njerëzit e duhur që do ta ndihmonin të modernizonte vendin, pa hequr dorë nga kontrolli i fortë mbi pushtetin që ishte thelbësor për të. Ai e gjeti një vend që sapo kishte dalë nga sundimi turk, me gjithë korrupsionin dhe të metat e tjera që nënkuptonte sistemi osman. Në dymbëdhjetë vjet midis rrëzimit të turqve dhe ardhjes në pushtet të Zogut, vendi kishte përjetuar disa pushtime të huaja, disa qeveri lokale apo jetëshkurtra dhe, për pjesën tjetër - anarki. Disa nga burrat e tij ishin mësuar të sundonin - por, sipas standardeve turke, tashmë të braktisura edhe nga vetë Turqia; të tjerët ishin mësuar vetëm të kundërshtonin autoritetin, nga cilado anë që të vinte ai.

Vetëm tre ose katër vjet më parë, Asambleja e Lidhjes së Kombeve diskutoi një raport të Komisionit të Mandateve për administrimin e Palestinës. U ngrit një delegat që pretendonte se ka njohuri të posaçme, meqë kishte qenë dikur Guvernator i Palestinës. Ky ishte vetë delegati i Shqipërisë, Mehdi Frashëri, i cili, përpara Luftës së Madhe kishte qeverisur për një kohë Palestinën nën Sulltanin turk. Despotizmi hamidian është po aq afër nesh. Ky lloj njeriu ishte materiali të cilin Zogu kishte në dorë kur kërkonte administratorë, ministra, përfaqësues diplomatikë, zyrtarë, prefektë. Po të vendosësh kabinetin aktual britanik si komisarë në shtetin sovjetik, kjo do të kishte në shumë gjasa sesa të prisje nga këto mbetje të Perandorisë Osmane të vendosnin standarde moderne administrative në Shqipëri - ose të qëndronin besnikë ndaj tyre edhe po të vendoseshin.

Parimi i parë i Shërbimit të Shtetit në kohët turke ishte: “Mos ia mbyll gojën kaut që shkel grurin”. Për më tepër, karriera e përbashkët e burokracisë dhe politikës shihej - dhe ende shihet në shumë pjesë të botës, përfshirë pjesë të Perandorisë Britanike - si rruga e vërtetë përmes së cilës një fshatar i varfër mund të ngjitet drejt ndikimit dhe pasurisë. Ishte fshatari shqiptar ai që u bë mysliman dhe vuri talentin e tij në shërbim të Sulltanit; ishte ai që kishte më shumë gjasa të përfundonte si Pashë, Nënmbret apo Vezir i Madh. Si në aspektin kohor, ashtu edhe në atë fetar, Shqipëria është vendi më pak i

shkëputur nga Perandoria Osmane dhe traditat e saj, nga të gjitha vendet e Ballkanit. I riu që dëshiron të përparojë, hyn në shërbimin publik. Edhe vetë udhëheqësi fisnor Zog ndërtoi karrierën e tij duke shërbyer në Regjencë si komandant i Përgjithshëm dhe ministër i Brendshëm, dhe kështu erdhi në pushtet. Fshatari gjen punë në një ministri apo në zyrën e një prefekti, dhe përparon prej andej. Rroga e tij do të jetë jashtëzakonisht e vogël; do të ketë një zbritje të madhe për “Ekonominë Kombëtare” - me fjalë të tjera, për t’ia mundësuar Mbretit të vazhdojë pa pasur nevojë për një tjetër hua italiane. Disa vite më parë, rroga shpesh nuk mbërrinte fare; në çdo rast, nuk do të ishte e madhe. Ky është shkaku tjetër kryesor i problemit. Një vend aq i varfër sa Shqipëria - ose aq dorështrënguar sa Turqia hamidiane - nuk mund të ofrojë paga të mira për nëpunësit civilë; ata duhet ta shpërblejnë veten “anash” gjatë rrugës. Fillimi i pasurisë është të marrësh një bakshish nga një kërkues, për t’ia mundësuar një takim me zyrtarin që ka ardhur të shohë. Përpara se të arrish te prefekti, gjykatësi apo ministri që ka pushtetin të zgjidhë çështjen tënde, duhet t’i japësh një dhuratë nëpunësit që të lejon të hysh. Nëse nuk e bën, ai thotë se ministri është i zënë; dhe ministri nuk merr vesh kurrë që ti ke qenë aty.

Pozitat e larta ofrojnë mundësi edhe më të mëdha. Imagjinoni veten si ministër, gati për të dhënë një kontratë për vendosjen e një numri të madh blloqesh betoni në det, në Durrës, në formën e një moli. Italia sapo ka dhënë paratë - prej të cilave ju, natyrisht, do të tërhiqni me bujari për “shpenzime”. Dhëndri juaj ka pak beton, ose e di se ku mund të gjendet, dhe fatura nuk do të shqyrtohet me shumë kujdes. E pandershme? Po, por si do të jetojë njeriu? Paga e një ministri të kabinetit është tridhjetë paundë në muaj; çfarë lloj karriere ofron kjo? Muajin tjetër, Mbreti mund t’ju shkarkojë dhe uk ka pension. Për më tepër, tani je anëtar i suksesshëm i familjes; të afërmit tuaj kërkojnë me ngulm vende formale pune, subvencione, pensione, kontrata, apo kush e di çfarë tjetër. Ju duhet një kostum i ri evropian për të pritur gazetarët e huaj; një frak për të marrë pjesë në banketin e Mbretit; një furnizim i pafund me cigare për të tymosur. Jeta është e lirë? Po, por jo aq e lirë nëse jeton si evropian. Së fundi, duhet të jetosh diku. Në vendin tënd, në mal, je rritur në një kasolle; ajo nuk bën për Tiranën. Ajo që të



duhet është të blini një truall në Bulevardin Zog dhe të ndërtoni një vilë të këndshme moderne me një kopsht dhe një mur përreth. Kjo kushton; shumë para. Kapitali juaj përfaqësohet nga disa paundë që keni arritur të kurseni (nëse keni mundur) kur ishit nënprefekt në ndonjë qytet provincial. Atëherë, si do të paguhen të gjitha këto gjëra? Epo, është kjo kontratë për molin krejtësisht të panevojshëm në Durrës, për të cilin italianët janë aq të interesuar. Çfarë mendoni për një përqindje anësore? Në mendjen e ministrit ekzistojnë dy shqetësime kryesore. I pari është përqindja e tij; i dyti është se si të krijojë aleancat e nevojshme, fasadën për Mbretin, dhe të tjera të ngjashme për të kapur mundësinë e qëndrimit të mëtejshëm në pushtet pas mandatit të parë. Edhe kjo kushton, ndaj le të marrim edhe pak më shumë nga përqindja!

Me rrezikun e lodhjes, duhet theksuar se kjo fasadë ëmbëltuese dhe përqindje anësore nuk janë mëkate të reja të shpikura posaçërisht nga shqiptarët; janë trashëgimi e shekujve. Në kohët turke, secili që nuk pajtohej të ruante bagëtinë në fshatin e tij, apo të mbillte për një mbijetesë minimale, gjithmonë jetonte nga përqindja, qoftë ai pashë, mbledhës taksash, nëpunës, shërbëtor, apo vetëm ndonjë gjyqtar lokal që merrej me ndonjë bej me prona. Kur Shqipëria u bë e pavarur, të gjithë mbanin mend që, kur ishin të rinj, të gjithë mernnin një përqindje ose ryshfet si diçka krejt e zakonshme; ndërgjegjja shoqërore që i dënon këto gjëra praktikisht nuk ekzistonte - të paktën jo te shtresa që e gjeti veten të jetë e para në shërbimin civil shqiptar.

As Zogu nuk mund të krijonte ndërgjegje duke hequr tundimin, përveçse me koston e mbushjes së Thesarit të zbrazët me një hua italiane - sipas kushteve të Italisë.

Shpesh ai e mbushte ashtu Thesarin; por nuk zgjaste shumë. Për të njëjtën arsye, të gjitha skemat e tij të tjera të shkëlqyera - për reformën agrare, bankat bujqësore, arsimin bujqësor dhe të tjera, e kush e di sa përmirësime - u vonuan vazhdimisht dhe u shtrinë në dekada, përderisa në një vend më pak të varfër do të kishin mjaftuar vetëm një apo dy vjet.

Me kushtet që kishte shërbimi publik, të gjithë ishin të gatshëm të drejtonin gishtin ndaj dikujt tjetër për marrje ryshfeti - sidomos nëse vetë nuk ishin pjesë e administratës dhe, për pasojë, nuk kishin mundësi të pasuroheshin në atë mënyrë duke përjetuar vetëm zhvatje si taksapagues dhe si ryshfetdhënës. Njerëzit spekulonin për ndershmërinë ose jo të këtij apo atij zyrtari. Prova ishte e thjeshtë: Filani erdhi në detyrë si njeri i varfër; e njohim të gjithë babanë dhe nënën e tij dhe fermën e tyre të mjerë. Ai ka qenë në detyrë për disa vite dhe tashmë ka dhënë dorëheqje. A është i pasur, apo ende i varfër? A kthehet i qetë në fermën familjare, si Et’hem Toto? Apo ka ndërtuar një shtëpi të bukur dhe vazhdon të bëjë jetë luksoze në Tiranë?

Një politikan britanik mund të justifikojë pasurinë e fituar duke thënë se një zonjë e moshuar, që e adhuronte atë, ia kishte lënë një pasuri, apo se kishte fituar bastet dhe i kishte shtuar fitimet në bursë; ose mund të ishte emëruar drejtor kompanie (midis mandateve), me shpërblime të majme; ose mund të kishte shkruar një ose dy libra apo ndonjë artikull sensacional dhe të paguar mirë në gazetë. Me pak fjalë, një njeri i varfër në politikë mund të bëhet disi i pasur pa qenë domosdo (ose aspak) i pandershëm. Nuk është kështu në Shqipëri. Nëse një ish-zyrtar i varfër ka ndërtuar një shtëpi të bukur, çmimi i saj ka ardhur, në një mënyrë apo tjetër, nga fondet

publike ose nga ryshfetet; shpërblimet zyrtare nuk do të mjaftonin për të dhe nuk ka bursë as gazetari të paguar mirë që të justifikojnë me ndershmëri këto para.

Ndërsa disa ministra thuhej se përfitonin mirë nga Ministria e Financave ose ajo e Punëve Publike, të tjerë, si Mehdi Frashëri dhe Et’hem Toto, gëzonin reputacion për ndershmëri të plotë. Duhet thënë menjëherë se, veçanërisht vitet e fundit, kishte një numër gjithnjë në rritje burrash me ndershmëri të vërtetë në shërbimin publik; Xhandarmëria, shkollat, studimet në universitetet perëndimore dhe vetë cilësitë themelore të karakterit shqiptar po nxirrnin një brez me një vizion më të ndritur.

Në këtë vend takon shqiptarë, të mërguar me Sovranin e tyre, mbi parimet dhe integritetin personal të të cilëve - si edhe mbi pikëpamjet e tyre të ndriçuara intelektuale - mund të mbështetesh me besim. Por, jo të gjithë shqiptarët i shikonin me të njëjtin sy shërbyesit e ndershëm publikë; disa vite më parë, një njeri i tillë vdiq, po aq i varfër sa kishte qenë, dhe një i pranishëm në varrimin e tij tha, me keqardhje për një sjellje kaq të pazakontë: “Iku edhe një budalla tjetër”!

Do të ishte padrejtësi e madhe të linim përshtypjen se e gjithë klasa politike shqiptare ishte e zhytur në korrupsion dhe përvetësim. Nëse tabloja është ekzagjruar disi në këtë kapitull, kjo shërben për të treguar se me çfarë sfidash përballej Mbreti Zog. I ndihmuar nga faktorët e lartpërmendur, dhe nga kalimi i kohës, ai arriti të sjellë përmirësime të dukshme. Se detyra e tij nuk u përmbush plotësisht, kjo është për shkak të italianëve të cilët e penguan në çdo hap dhe, në fund, ia prenë rrugën. /Telegrafi/

[1] Pjesë nga: Vandeleur Robinson. Albania’s Road to Freedom (London: Allen & Unwin, 1941). fq. 115-119.



Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

## Prishtina, lidere e Superligës

PRISHTINË, 26 SHTATOR - Prishtina ka vazhduar paraqitjet e mira në këtë fillim edicioni në AlbiMall Superligë, teksa ka fituar me shifrat 2:0 ndaj Prishtinës së Re në ndeshjen përmbyllëse

të javës së 6 që është zhvilluar në stadiumin “Fadil Vokrri”. Golat për bardhekaltrit i kanë shënuar Mario Ilievski në minutën e 17 dhe Blend Baftiu në minutën e 68, duke siguruar

tri pikët e plota për skuadrën e trajnerit Arsim Thaqi. Me këtë fitore Prishtina është rikthyer në vendin e parë të tabelës së AlbiMall Superligës së Kosovës falë diferencës më të mirë të

golave krahasuar me Dukagjinin e Klinës. Aktualisht Prishtina dhe Dukagjini kanë nga 13 pikë, një më shumë se Ballkani, ndërsa Drenica renditet e katërta me 11 pikë.



## BALLKANI FITON DERBIN NDAJ DRITËS, DUKAGJINI DHE MALISHEVA FITOJNË ME PËRMBYSJE, DRENICA BEFASON EDHE GJILANIN

PRISHTINË, 26 SHTATOR - Ballkani ka shënuar fitore të rëndësishme në derbin e javës së gjashtë të AlbiMall Superligës së Kosovës në futboll, duke mposhtur kampionen në fuqi, Dritën, me rezultat 2:0, në stadiumin e qytetit në Suharekë. Skuadra portokallezi vazhdon të jetë ndër pretendentet kryesore për titull, ndërkohë që Drita mbetet në krizë rezultatesh në këtë fillim edicioni.

Fitore të rëndësishme ka shënuar edhe Dukagjini i cili ka përmbysur rezultatin ndaj Llapit në ndeshjen e zhvilluar në stadiumin “18 Qershori” në Klinë. Mysafirët nga Podujeva kaluan të parët në epërsi në minutën e 8 me golin e Axel Gnapit, por vendësit reagueshan fuqishëm. Dënit Isufi ka barazuar me një supergol në fundin e pjesës së parë (45+1’), ndërsa Altin Merlaku (61’) dhe Iljasa Zulfiji (88’) kanë përmbysur plotësisht rezultatin, duke i dhënë Dukagjinit fitoren e katërt sezonalë. Pas këtij rezultati,



Dukagjini ngjitet në vendin e parë me 13 pikë, duke konfirmuar formën e mirë të skuadrës së drejtuar nga Ismet Munishi, ndërsa Llapi vazhdon të mbetet

në fund të renditjes me vetëm tri pikë dhe pa fitore të regjistruar deri tani. Drenica ka marrë tri pikë të vlefshme në udhëtim ndaj

Gjilanit. Goli i vetëm i ndeshjes është shënuar në minutën e 90+5’ nga Genc Hamiti, pas një gabimi të rëndë në mbrojtjen e vendësve. Me këtë fitore kuqezinjët nga

Skenderaj kanë arritur në kuotën e 11 pikëve dhe renditen të tretët në tabelë, ndërsa Gjilani mbetet me shtatë pikë në pozitën e pestë. Edhe Malisheva ka arritur fitore me përmbysje të rezultatit para tifozëve të vet, duke e mposhtur Ferizajn me rezultat 3:1. Me këtë fitore Malisheva ngjitet në kuotën e 7 pikëve dhe pozicionohet në mesin e tabelës. Ferizaj, ndërkohë, bie në vendin e tetë me gjashtë pikë të grumbulluara.

### XHIROJA E GJASHTË/RENDITJA E KLUBEVE

|                |    |
|----------------|----|
| Prishtina      | 13 |
| Dukagjini      | 13 |
| Ballkani       | 12 |
| Drenica        | 11 |
| Gjilani        | 7  |
| Malisheva      | 7  |
| Prishtina e Re | 6  |
| Ferizaj        | 6  |
| Drita          | 5  |
| Llapi          | 3  |

## FIFA PLANIFIKON NDRYSHIM DRASTIK PËR PENALLTI



PARIS, 26 SHTATOR - Shtëpia botërore e futbollit, FIFA, është duke planifikuar ndryshim rrënjësor sa i përket ekzekutimit të penalltive. FIFA është duke planifikuar që në të ardhmen, nëse një futbollist dështon të shënojë nga penalltia, topi automatikisht do t’i takojë portierit për ta nisur aksionin e ri, pavarësisht se në cilin drejtim shkon topi. Kjo do të krijonte ndryshim të madh. Lojtarët do të kenë vetëm një tentim për ekzekutimin e penalltisë,

ndërsa lojtarët e tjerë nuk do të kenë nevojë të qëndrojnë afër vijës së 16-metërshit gjatë gjuajtjes. Nuk do të ketë as kartonë të verdhë për lojtarët që hyjnë më herët në zonë. Ende nuk është krejtësisht e qartë se çfarë do të ndodhë nëse topi qëllon shtyllën, pa e prekur portieri fare atë. Ish-gjyqtari spanjoll, 58-vjeçari Eduardo Iturralde, ka folur për “Cadena SER” për këtë çështje, duke theksuar se kreu i gjyqtarëve të FIFA-s, 65-vjeçari Pierluigi Collina, është

admirues i madh i këtij revolucion. “Do të ishte bekim për portierët, për të cilët veçse është e vështirë pritja e penalltisë”, kishte thënë për këtë rregull Collina para një muaji, në një intervistë dhënë për gazetën italiane “La Repubblica”. Rregulli i ri mund të nisë së zbatuari prej edicionit 2026/27. Kjo do të thotë se Botërori 2026 në Kanada, Meksikë dhe ShBA, do të jetë turneu i fundit madhor me rregull të vjetër të penalltive.

## Superliga e Kosovës në futsal nis në fundjavë

PRISHTINË, 26 SHTATOR - Superliga e Kosovës në futsal do të nisë në këtë fundjavë me edicionin e ri 2025/26. Java e parë do të zhvillohet nesër (e

diel) dhe të hënën me disa duele interesante në program. Të dielën FC Liqeni përballët me FC Trepçën në Drenas, ndërsa në

kryeqytet do të luhet derbi mes FC Mabetex Prishtina dhe FC Drenicës. Të hënën në kuadër të javës së parë FC Drenasi do ta

sfidojë FC Shtimja 26, kurse FC Malisheva pret FC Prishtina 01. Skuadra e FC Obiliqit do të pushojë këtë javë.



## TRUMPI PARALAJMËRON ZHVENDOSJE TË NDESHJEVE TË KUPËS SË BOTËS 2026 NGA QYTETET E PASIGURTA

UASHINGTON, 26 SHTATOR - Presidenti i ShBA-së, Donald Trump, ka paralajmëruar se është i gatshëm t'i zhvendosë ndeshjet e Kupës së Botës 2026 nga çdo qytet amerikan që ai e konsideron të pasigurt. Kupa e Botës do të bashkorganizohet nga ShBA-ja, Kanadaja dhe Meksika, me 78 nga 104 ndeshjet që do të luhen në

tokën amerikane, përfshirë edhe finalen.

Në listën e 11 qyteteve pritëse në ShBA janë Atlanta, Bostoni, Dallasi, Houstoni, Kansas City, Los Angeles, Miami, Nju-Jorku/Nju Jersey, Philadelphia, San Francisco dhe Seattle. Pikërisht për këto tri të fundit, bastione demokrate, Trumpi është shprehur më i shqetësuar,

duke i cilësuar potencialisht të pasigurta.

"Do të jetë e sigurt për Kupën e Botës, por nëse mendoj se nuk është, ndeshjet do t'i zhvendosim në një qytet tjetër", ka thënë Trumpi nga Zyra Ovale. Megjithatë, mbetet e paqartë nëse presidenti amerikan ka autoritet të drejtpërdrejtë për t'i ndryshuar qytetet pritëse, pasi

organizimin e ka në dorë FIFA. Një ndryshim i tillë do të sillte sfida të mëdha logjistike. Trumpi, megjithatë, gëzon marrëdhënie të afërta me presidentin e FIFA-s, Gianni Infantino, dhe udhëheq taskforcën e posaçme për Kupën e Botës.

Trumpi ka vendosur luftën kundër krimit në qendër të

politikës së tij dhe muajt e fundit ka angazhuar Gardën Kombëtare në disa qytete amerikane, përfshirë Uashington DC dhe Los Angeles.

Kupa e Botës 2026 do të mbahet nga 11 qershori deri më 19 korrik, ndërsa shorti për fazën e grupeve është planifikuar më 5 dhjetor në Uashington DC.



## 'THE TIMES': ANËTARËT E UEFA-s PRO PEZULLIMIT TË IZRAELIT, VOTOHET JAVËN E ARDHSHME

BAZEL, 26 SHTATOR - Shtëpia evropiane e futbollit, UEFA, pritët që javën e ardhshme të marrë vendim për pezullimin ose jo të Izraelit, por shumica e anëtarëve të komitetit ekzekutiv të saj merret vesh se janë pro kësaj mase, raporton gazeta e njohur britanike, "The Times".

Një panel i këshilltarëve në Kombet e Bashkuara u kanë bërë thirrje FIFA-s dhe UEFA-s që ta pezullojnë Izraelin, pasi një Komision Hetues i OKB-së konkludoi se Izraeli është duke kryer gjenocid në Gaza, thuhet në artikullin e së përditshmes britanike.

Burimet i kanë thënë gazetës se UEFA do të marrë një vendim javën e ardhshme dhe se një shumicë e madhe e

anëtarëve ekzekutivë si dhe federatave të vendeve anëtare janë në favor të pezullimit, duke e përmendur pezullimin e Rusisë nga garat evropiane që nga fillimi i pushtimit të plotë të Ukrainës në vitin 2022.

UEFA, organizatë në të cilën Izraeli është anëtar që nga viti 1994, ka mbajtur diskutime serioze në nivelin më të lartë këtë javë për veprimet e Izraelit në Gaza dhe për atë se si duhet të reagojë institucioni më i lartë evropian i futbollit ndaj kësaj situatë. Gazeta "The Times" muajin e kaluar mori vesh se disa klube evropiane të futbollit e kishin pyetur UEFA-n nëse ekzistonte ndonjë mënyrë që ato ta shmangin ballafaqimin me ekipe izraelite.





Duke u bazuar ne Rregulloren për dhënie me qera te pronës së paluajtshme të Trepçës Sh.A. me numër protokolli 119 date 11.01.2021, Zyra e shitjes me datën 26.09.2025 bënë shpallje publike për dhënin e pronës së paluajtshme me qera.

Shpallje Publike  
T-25-9

Autoriteti Kontraktues (AK): Trepça Sh.A.  
Adresa e AK: Parku Industrial  
MITROVICË  
40000  
Personi Kontaktues: Arjanit Ademi  
E-mail: arjanit.ademi@trepcasha.com  
Telefoni: +381 28 538 050  
Faks: +381 28 539 202

Shpallja Publike

- Qëllimi i ofertës:**
- Dhënie me qera e hapësirave
  - Sipërfaqja dhe çmimi fillestar

| Loti 1 |                                          |                 |                |               |           |            |
|--------|------------------------------------------|-----------------|----------------|---------------|-----------|------------|
| Nr     | Objekti - Magjistralja Mitrovicë-Bajgorë | Sipërfaqja (m²) | Çmimi neto (€) | Çmimi pa TVSH | TVSH 18 % | Tatimi 9 % |
| 1      | P-71208128-00704-2                       | 260.00          | 0.75           | 195           | 35.100    | 17.55      |

| Loti 2 |                      |                 |                |               |           |            |
|--------|----------------------|-----------------|----------------|---------------|-----------|------------|
| Nr     | Objekti - Depo - PIM | Sipërfaqja (m²) | Çmimi neto (€) | Çmimi pa TVSH | TVSH 18 % | Tatimi 9 % |
| 1      | P-71208128-001090-1  | 550.00          | 0.70           | 385           | 69.300    | 34.65      |

| Loti 3 |                           |                 |                |               |           |            |
|--------|---------------------------|-----------------|----------------|---------------|-----------|------------|
| Nr     | Magjistrale te Adriatikut | Sipërfaqja (m²) | Çmimi neto (€) | Çmimi pa TVSH | TVSH 18 % | Tatimi 9 % |
| 1      | P-71208128-001090-2       | 9178.00         | 0.59           | 5415.02       | 974.704   | 487.35     |

| Loti 4 |                           |                 |                |               |           |            |
|--------|---------------------------|-----------------|----------------|---------------|-----------|------------|
| Nr     | Objekti - Depo I.Baterive | Sipërfaqja (m²) | Çmimi neto (€) | Çmimi pa TVSH | TVSH 18 % | Tatimi 9 % |
| 1      | P-71208128-001090+0       | 1000.00         | 0.88           | 880           | 158.400   | 79.20      |

| Loti 5 |                    |                 |                |               |           |            |
|--------|--------------------|-----------------|----------------|---------------|-----------|------------|
| Nr     | Hapësira - Badovc  | Sipërfaqja (m²) | Çmimi neto (€) | Çmimi pa TVSH | TVSH 18 % | Tatimi 9 % |
| 1      | P-73414004-00216-1 | 730.00          | 0.50           | 365           | 65.700    | 32.85      |

| Loti 6 |                     |                 |                |               |           |            |
|--------|---------------------|-----------------|----------------|---------------|-----------|------------|
| Nr     | Hapësira - Stanterg | Sipërfaqja (m²) | Çmimi neto (€) | Çmimi pa TVSH | TVSH 18 % | Tatimi 9 % |
| 1      | P-71208112-00124-0  | 700.00          | 0.30           | 210           | 37.800    | 18.90      |

| Loti 7 |                     |                 |                |               |           |            |
|--------|---------------------|-----------------|----------------|---------------|-----------|------------|
| Nr     | Hapësira - Stanterg | Sipërfaqja (m²) | Çmimi neto (€) | Çmimi pa TVSH | TVSH 18 % | Tatimi 9 % |
| 1      | P-71208112-00131-0  | 30.00           | 0.80           | 24            | 4.320     | 2.16       |

| Loti 8 |                     |                 |                |               |           |            |
|--------|---------------------|-----------------|----------------|---------------|-----------|------------|
| Nr     | Hapësira - Stanterg | Sipërfaqja (m²) | Çmimi neto (€) | Çmimi pa TVSH | TVSH 18 % | Tatimi 9 % |
| 1      | P-71208112-00131-0  | 30.00           | 0.80           | 24            | 4.320     | 2.16       |

| Loti 9 |                     |                 |                |               |           |            |
|--------|---------------------|-----------------|----------------|---------------|-----------|------------|
| Nr     | Hapësira - Stanterg | Sipërfaqja (m²) | Çmimi neto (€) | Çmimi pa TVSH | TVSH 18 % | Tatimi 9 % |
| 1      | P-71208112-00131-0  | 30.00           | 0.80           | 24            | 4.320     | 2.16       |

| Loti 10 |                    |                 |                |               |           |            |
|---------|--------------------|-----------------|----------------|---------------|-----------|------------|
| Nr      | Objekti - Stanterg | Sipërfaqja (m²) | Çmimi neto (€) | Çmimi pa TVSH | TVSH 18 % | Tatimi 9 % |
| 1       | P-71208112-00131-0 | 30.00           | 0.80           | 24            | 4.320     | 2.16       |

| Loti 11 |                      |                 |                |               |           |            |
|---------|----------------------|-----------------|----------------|---------------|-----------|------------|
| Nr      | Hapësira - Te tuneli | Sipërfaqja (m²) | Çmimi neto (€) | Çmimi pa TVSH | TVSH 18 % | Tatimi 9 % |
| 1       | P-71208128-01076-1   | 750.00          | 0.59           | 442.5         | 79.650    | 39.83      |

| Loti 12 |                      |                 |                |               |           |            |
|---------|----------------------|-----------------|----------------|---------------|-----------|------------|
| Nr      | Hapësira - Te tuneli | Sipërfaqja (m²) | Çmimi neto (€) | Çmimi pa TVSH | TVSH 18 % | Tatimi 9 % |
| 1       | P-71208128-01076-1   | 547.82          | 0.59           | 323.2138      | 58.178    | 29.09      |

| Loti 13 |                                   |                 |                |               |           |            |
|---------|-----------------------------------|-----------------|----------------|---------------|-----------|------------|
| Nr      | Hapësira - FPP, P-71208072-2649-0 | Sipërfaqja (m²) | Çmimi neto (€) | Çmimi pa TVSH | TVSH 18 % | Tatimi 9 % |
| 1       | Sip. e mbuluar                    | 160.00          | 2.00           | 320           | 57.600    | 28.80      |
| 2       | Sip. e pambuluar                  | 100.00          | 0.50           | 50            | 9.000     | 4.50       |

Kriteret e Dhënies: Dhënia e kontratës do të bazohet në çmimin më të lartë  
Data e shpalljes: 26.09.2025  
Sqarimi: deri me 13.10.2025  
Kërkesa për pjesëmarrje: Data(t) për kërkesës deri: 13.10.2025  
Bëhet në e-Mail: poshtë shënuar ose në Zyrën e shitjes dhe qirasë.  
Dorëzimi i ofertave: Dorëzimi i ofertave bëhet ne formë fizike (zarf te mbyllur) (Originali dhe Kopja)  
  
Afati i fundit i dorëzimit: 13.10.2025 në 11:00  
Vendi i dorëzimit: Zyra e shitjes dhe qirasë të Trepça Sh.A. Parku Industrial, Mitrovicë (PIM)

- Kërkesat minimale të kualifikimit:
- Kopja e certifikatës së regjistrimit të biznesit të entitetit.
  - Kopje të certifikatës së regjistrimit për TVSH ( vetëm për ofertuesit vendor)
  - Vërtetim i lëshuar nga Administrata Tatimore se operatori ekonomik në fjalë nuk është në vonës në pagesën e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të njoftimit për kontratë.
  - Nuk ka obligime ndaj Trepçës të pa paguara.

**Shënime shtesë:**  
**Çmimi i ofertës:** Çmimi i ofruar nga O.E të interesuar do të jetë më i madh apo i barabartë me çmimin e parashikuar nga Autoriteti Kontraktues - Trepça Sh.A.  
**Obligimet:** Ofertuesi fitues do të bartë të gjitha obligimet e investimeve si dhe te gjitha shpenzimet administrative, komunale dhe shpenzimet tjera të cilat dalin mbas lidhjes së kontratës.  
**Oferta:** Duhet të përfshijë çmimin për m² duke përfshirë TVSH-në dhe Çmimin total shih Aneks1.  
**Pagesa:** Të gjitha pagesat do të bëhen në EURO, pa ndalesë, kundërkërkesë ose çfarëdo zbritje në llogarinë bankare të Trepça Sh.A.  
**Operatorët ekonomik:** që nuk i paraqesin të gjitha të dhënat për formimin e çmimit Aneks 1 dhe deklarimi Aneksi 2 Ofertat e tyre nuk do të shqyrtohet.

Aneksi 1 OFERTA

|            |  |
|------------|--|
|            |  |
| Emri i OE: |  |
| Loti       |  |
| Kodi (T)   |  |

| D=a*c        | Vlera e qerasë për sipërfaqen e mbuluar (€) |  |
|--------------|---------------------------------------------|--|
| a            | Sipërfaqe m²                                |  |
| b            | Çmimi për m²                                |  |
| c = a*b      | Vlera pa TVSH                               |  |
| d = c * 18 % | TVSH 18 %                                   |  |
| e = c + d    | Total                                       |  |
| f = c * 9 %  | Tatimi - 9 %                                |  |
| g = e - f    | Për pagesë                                  |  |

Tatimi në qira prej 9% gjithashtu bije në barrë të qiramarrësit dhe pagesën e saj e bënë qiramarrësi

|             |  |
|-------------|--|
| Nënshkrimi: |  |
| Data:       |  |
| Vula:       |  |

Aneksi 2 DEKLARATA NËN BETIM

Unë, i poshtë nënshkruari, duke përfaqësuar: *operatorin ekonomik që paraqitet* deklaroj nën betim se jam i përshtatshëm në përputhje me Rregulloren për dhënie me qira te pronës se paluajtshme të Trepçës Sh.A. me numër protokolli 119 date 11.01.2021.  
Unë vërtetoj se i kam lexuar kërkesat e përshtatshmërisë në rregulloren dhe siguroj se jam i përshtatshëm të marrë pjesë.  
Unë pranoj mundësinë e sanksionimeve penale dhe civile, gjobave dhe dënimeve, nëse unë për shkak të pakujdesisë dorëzoj çfarëdo dokumenti ose deklarata që përmban informata përmbytësish të gabueshme ose mashtruese.


|                                         |  |
|-----------------------------------------|--|
| Identifikimi i Operatorit Ekonomik (OE) |  |
| Emri i OE:                              |  |
| Adresa e plotë:                         |  |
| I përfaqësuar nga:                      |  |
| Emri:                                   |  |
| Pozita:                                 |  |
| E-mail:                                 |  |
| Tel:                                    |  |
| Nënshkrimi:                             |  |
| Data:                                   |  |
| Vula:                                   |  |

**Aneks 3. Pjesëmarrja**  
Pjesëmarrja - Marrja e Aplikacionit mund të behet deri me datën **13.10.2025** përmes e-mail ose në Zyren e Shitjes.

**Aneks 4. Përshkrimi i Aseteve**  
Përshkrimi i aseteve të shënuara më poshtë shërbejnë vetëm për qëllime të informimit dhe Autoriteti Kontraktues nuk ofron garanci të saktësisë së përshkrimit. Këto asete jepen në kushte të gjendjes aktuale “ashtu siç janë dhe ku janë” dhe autoriteti kontraktues nuk ofron Garancion në lidhje me gjendjen e aseteve. Tenderuesi bartë rrezikshmërinë e plotë për gjendjen e aseteve.

Objekti është i ndarë në lote.

**Trepça Sh.A.** përmes këtij njoftimi përcakton kushtet dhe termet dhënës me qiratë objekteve dhe hapësirave sipas tenderit me metodën e çmimit ekonomikisht më të lartë, bazuar në parametrat e poshtëshënuar që përcaktojnë formimin e çmimit ekonomikisht më të lartë.



Kompania Regjionale e Mbeturinave "Ambienti" Sh.A. Pejë  
Me adresë Rr.Xhem Sadrija pn ,Fusha e Pejës-Tranzit KK Pejë

KOMPANIA REGJIONALE E MBETURINAVE  
"Ambienti" SH.A PEJË  
NR. 2542  
DATA 26.09.2025

Bazuar ne ligjin e Punës: LIGJI Nr. 03/L-212 sipas nenit 8,dhe në bazë të Udhëzimit Administrativ MFPT- NR 01/2024, Kryeshefi Egzekutiv i Kompanis Regjionale të Mbeturinave "Ambienti" Sh . A. Pejë me datë 29.09.2025, shpall konkurs të jashtëm për këto vende të punës :

**KONKURS**

**Pozita : Kontroller i brendshëm (inspektor) - 1 pozitë**

**Vendi punës : Pejë**  
**Kohëzgjatja e periudhës provuese është 6 muaj me mundësi vazhdimi sipas kontratave të ligjit të punës.**  
**Koeficienti i pagës : 2.5**

Përshkrimi i detyrave dhe përgjegjësi të punës:

- Obligohet që në terren të silltet korrekt dhe të mbajë uniformë dhe shenjë identifikimi të Ndërmarrjes.
- Në baza ditore merr urdhëra nga udhëheqësi i inspektorëve për ankesat dhe kërkesat që duhet inspektuar , angazhohet drejtpërdrejt me rastin e zgjedhjes së ankesave dhe është përgjegjës për dhënien e shenimeve të duhura për zgjidhjen e këtyre kontesteve në afat sa më të shpejtë.
- Raporton tek udhëheqësi i inspektorëve të gjitha proqeset që i ka inspektuar sipas rregullores së punës.
- Jep përgjegjësi për moskryerjen e ankesave që i janë deleguar nga udhëheqësi i inspektorëve.
- Sipas planit mujor të udhëheqësit të inspektorëve, bën inspektimin, monitorimin dhe rishikimin e aktiviteteve të inkasatëve në terren se a është bërë dorëzimi i faturave të konsumatorët dhe kontrollon se a janë të gjitha faturat në rregull.
- Kontrollerët e brendshëm duhet të verifikojn në vazhdimsi listat e klientëve në teren dhe të bëjnë përditësimin e të dhënave të klientëve ekzistues, regjistrimin e klientëve të rinjë.
- Kontrollerët e brendshëm duhet të inspektojnë kryerjen e punëve në terren mbi shërbimin e mbeturinave dhe të raportojnë për gjetjet të udhëheqësi i inspektorëve.
- Kontrollerët, në bazë të kontrollimit të gjendjes reale dhe të gjetjeve në terren, raportojnë tek udhëheqësi i inspektorëve me shkrim.
- Raporton punën ditore, mujore dhe vjetore të udhëheqësi i inspektorëve.
- Detyrohet të zbatojë disiplinën në punë, kodin e etikës, rregulloret / rregullat e caktuara nga ndërmarrja për këtë proces pune dhe në rast të shkeljes së tyre mban përgjegjësi disiplinore.
- Kryen edhe punë të tjera operative me urdhëresë të udhëheqësit të inspektorëve.
- Për mosrespektimin e pikave të lartcekura i përgjigjet drejtpërdrejt Kryeshefit Ekzekutiv.

a. **Kushtet e përgjithshme :**

- CV;
- Çertifikatë që kandidati nuk është nën hetime;
- Letër motivimi;
- Kopja e letërnjoftimit;
- Çertifikatë mbi gjendjen shëndetësore.

b. **Kushtet e veçanta :(kualifikimet profesionale)**

- Shkolla e Mesme, e preferuar Diplomë Universitare;
- Njohja e punës me kompjuter;
- Aftësia të mira komunikimi ;
- 1 vit përvojë pune e dëshmuar ;
- Ai /Ajo duhet të jenë në gjendje të punojë nën presion, të ketë moral të fortë për punë dhe integritet të nivelit të lartë.

**Mënyra e Aplikimit :** Dokumentacioni duhet të dërgohet ne e-mailit [krmambientikonkurset@gmail.com](mailto:krmambientikonkurset@gmail.com)  
Data e për aplikim është nga 29.09.2025 deri me 14.10.2025 ora 12:00. Dokumentacioni që mbërrin pas afatit dhe i pakompletuar do të konsiderohet i pavlefshëm.. Dokumentet origjinale mund të kërkojnë, sipas nevojës. Vetëm kandidatët e selektuar për listën e ngushtë do të kontaktohen.



# Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Cje Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook  [www.facebook.com/gjeipuneshejte](http://www.facebook.com/gjeipuneshejte)

# RESTAURANT

---

# SWISS

---

# TAVERNA

---

Tel: +377 45 400 156  +386 49 848 553

PRISHTINË



# Lume's Details

## Estetik & Depilim



 044 900 978 | 045 687 898

 Sallon Depilimi Lume's Details

 lumesdetails

 Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

**>> SHPALLJE TË VOGLA <<**

- Hysni Sufaj shpall të pavlefshme dëftesën e plotë të sh.f.m.u. “Hamëz Cena Damjan Gjakovë, 1-8.

Frrok Palokaj shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12 të sh.m.t. “Nexhmedin Nixha” Gjakovë.

Jetmir Muharrem Bardhi shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme “Fehmi Lladrovci” Glllogoc.

Lumturija Avdyli shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12 si dhe diplomën e Gjimanzit “Eqrem Çabej” Prishtinë.

Blerim Memaj shpall te pavlefshme 4 dëftesat dhe certifikatën QK “11 Marsi” Prizren.

Ali Kastrati shpall te pavlefshme diplomën QK “11 Marsi” Prizren.

Elsid Idrizi shpall te pavlefshme 3 dëftesat dhe diplomën QK “11 Marsi” Prizren.

Gjon Gojani shpall te pavlefshme dëftesat dhe diplomën shme “ Ymer Prizreni “ Prizren.

- Adem Shabanaj shpall te pavlefshme dëftesat, certifikatën e testit maturës, diplomën shme “Ymer Prizreni” Prizren.

- Berat Krasniqi shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu “Luigj Gurakuqi” Nashec.

- Florind Gurazi shpall te pavlefshme 1 dëftesë Q.K “11 Marsi” Prizren.

- “Vr Digital Agency” L.L.C. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. Unik Identifikues: 811430686.

- “Reisa 2022” SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e TVSH-së, me nr 330514530.

- “Fire Protection Agency Rifiel Action” L.L.C. shpall të pavlefshme certifikatën e TVSH-së, me nr. 330530669.

- Bekim Selimaj shpall të pavlefshme diplomën e Kolegjit Biznesi.

Meritë Bytyqi shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme të mjekësisë “Luciano Motroni” Prizren.

- Blend Mustafaj nga Deçani, shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12 si dhe diplomën e sh.m. mjekësisë “Htsni Zajmi”.

- Simunida Maksuti shpall te pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12.13. si dhe Diplomën e sh.m. Prof. “Gjon Nikolle Kazazi” Teknologji Informative Gjakove.

### NJOFTIM

Njoftojme te gjithë klientet se Shoqëria me Përgjegjësi te Kufizuar "Shala Wine" Sh.P.K. me seli në Mitrovicë, ka marrë vendim te shuajë biznesin me nr.b UNIK: 810117772, dhe ka caktuar likuidatorin per zhvillimin e procedures se Likuidimit. Njoftohen te gjithë klientët qe kane raporte Kreditore - Debitore ne këte korporate që te paraqiten ne afatin 30 ditor nga data e shpalljes ne gazetë.

### OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "Shala Wine" D.O.O. od Mitrovicë donelo odlukuo prestani rada sa nr.b: 810117772, ujedno imenovao Likvidatorao sprovođenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavijivanja o novine.

### ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability "Shala Wine" L.L.C. with headquarters Mitrovicë, has come to the decision to quit its business: 810117772, the company has appointet a liguidator who is going to oversee the liguidator process. All clients who have the mortgager - mortgage accounts in this company are kindly request to showup within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.



## Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook

[www.facebook.com/gjejpuneshejte](http://www.facebook.com/gjejpuneshejte)

## RESTAURANT

# SWISS

## TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË





# TRADITË QË NGA 1992

